



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit, 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes propozon:

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e dates 4 qershor 2008, si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës _____ 2026, të miratojë këtë :

PROPOZIM

VENDIM

PËR FORMIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PROJEKT - RREGULLORES SË
RE TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË LIPJANIT

Neni 1

Përbërja

Me këtë Vendim formohet grupi punues për hartimin e Projekt – Rregullores së re të punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit, në përbërje si vijon:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit të Komunës, Kryesues,
2. _____, anëtar i kuvendit nga subjekti politik LDK, anëtar/e
3. _____, anëtar i kuvendit nga subjekti politik LDK, anëtar/e
4. _____, anëtar i kuvendit nga subjekti politik PDK, anëtar/e
5. _____, anëtar i kuvendit nga subjekti politik LVV, anëtar/e
6. Vlora Krasniqi , Udhëheqëse e Sektorit për përfaqësim dhe çështje ligjore, anëtare
7. Behar Aliu , Zyrtar Ligjor, Sektori për punë të Kuvendit dhe të komiteteve , anëtar

Neni 2

Detyrat e grupit punues

1. Grupi punues ka për detyrë të bëjë hartimin e Projekt –Rregullores së re të Kuvendit të Komunës së Lipjanit , duke u bazuar në dispozitat përkatëse ligjore në fuqi më së largu brenda afatit 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
2. Grupi punues duhet t'i ndjekë procedurat e konsultimit publik sipas dispozitave ligjore përkatëse dhe të mbajë takim publik të hapur duke mbajtur procesverbal në bashkëpunim me Zyrtaren përgjegjëse për konsultime publike të Komunës së Lipjanit.

Neni 3 Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës.

Arsyetim

Baza juridike

Baza juridike për të propozuar këtë Vendim është e përcaktuar me dispozitat e nenit 58 shkronja h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 40 shkronja h.) e Statutit të Komunës së Lipjanit.

Baza juridike dhe obligimi ligjor për të miratuar këtë Vendim është e përcaktuar, nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e dates 4 qershor 2008, si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021.

Kuvendi i Komunës së Lipjanit me datë 07.11.2008 ka miratuar Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit .

Me qenë se kanë kaluar mbi 17 vite që kjo Rregullore nuk ka pasur asnjë ndryshim plotësim e në anën tjetër Statuti i Komunës së Lipjanit i vitit 2008, bazuar në të cilin është miratuar kjo Rregullore është ndryshuar në fund të vitit 2021 përkatësisht është miratuar Statuti i ri i Komunës së Lipjanit, konsiderohet e nevojshme të shqyrtohet mundësia e ndryshimit të Rregullores aktuale të Kuvendit të Komunës në harmoni me dispozitat përkatëse ligjore

Nga të cekurat më lartë, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

1Nr. 020/04-4486
Lipjan, më 28.01.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

